



Address: Lagjia 14, Rruga "Dituria", Ish UMB, Shkozet, Durres
Mobile: +355697037155
E-mail: info@liqeni7.al
Website: www.liqeni7.al

Nr. 257 prot.

Durrës, më 22.10.2022

Lënda: Njoftim për thirrjen e asamblesë së aksionerëve të shoqërisë
"LIQENI VII" sh.a.

Subjekti: Për shqyrtimin e ndryshimit të formës ligjore, nëpërmjet shndërrimit nga
shoqëri e formës Shoqëri Anonime në Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar.

Nga : Administratoret,
Z.Musa Kalia
Znj.Resilda Kalia

Drejtuar: Aksionereve të shoqërisë "LIQENI VII" sh.a Durrës
1- Aksionerit Z.Ramazan Kalia,
2- Aksionerit Z.Kujtim Deti,
3- Aksionerit Znj.Shpresa Deti,
4- Aksionerit Znj.Arbentina Berzezi.

Në cilësinë e Administratoreve të shoqërisë "LIQENI VII" sh.a. konform dispozitave ligjore të nenit 216, 229 të ligjit 9901, dt.14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" të Statutit të shoqërisë, po ju drejtohem për t'ju komunikuar se mbledhja e asamblesë për të shqyrtuar ndryshimin të formës ligjore, nëpërmjet shndërrimit nga shoqëri e formës shoqëri anonime në shoqëri me përgjegjësi të kufizuar do të mbahet pranë selisë së shoqërisë të shoqërisë "LIQENI VII" sh.a.(Rruga "Dituria", Zona Kadastrale nr.8516, Nr.pasurie 10/268, Lagjia 14, Kodi Postar 2007, Shkozet) në datën 14.11.2022, ora 10.00.

Rendi i ditës së kësaj mbledhje do të jetë si më poshtë:

- Shqyrtimi i ndryshimit të formës ligjore, nëpërmjet shndërrimit nga shoqëri e formës shoqëri anonime në shoqëri me përgjegjësi të kufizuar.
- Shqyrtimi dhe miratimi i raportit të administrimit ku do të shpjegohen në mënyrë të hollësishme, bazat ligjore dhe ekonomike të shndërrimit të propozuar. Në raport do të përshkruhen edhe vështirësitë e veçanta të vlerësimit, të cilat janë hasur. Në raport do të përshkruhet edhe efekti, që do të ketë shndërrimi tek punëmarrësit e shoqërisë.
- Shfuqizimin e Statutit të Shoqërisë si Statut i një Shoqëri Anonime "LIQENI VII" sh.a dhe miratimi i Statutit të ri të Shoqërisë si Statut i Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar "LIQENI VII" Sh.p.k.
- Të tjera.

Mbledhja do të organizohet pranë selisë së shoqërisë, Rruga "Dituria", Zona Kadastrale nr.8516, Nr.pasurie 10/268, Lagjia 14, Kodi Postar 2007, Shkozet), në datën 08.11.2022, ora 10.00.

ADMINISTRATORET

Z.Musa Kalia



Znj.Resilda Kalia





Address: Lagjia 14, Rruga "Dituria", Ish UMB, Shkozet, Durres
Mobile: +355697037155
E-mail: info@liqeni7.al
Website: www.liqeni7.al

Durrës, më 15.11.2022

Lënda: Njoftim për shtyrjen e mbledhjes së asamblesë së aksionerëve të shoqërisë "LIQENI VII" sh.a ne daten 10.12.2022 ora 10:00 per shkak te mospjesemarrjes se asnjërit prej aksionereve ne mbledhjen e thirrur ne daten 14.11.2022 ora 11:00.

Subjekti: Për shqyrtimin e ndryshimit të formës ligjore, nëpërmjet shndërrimit nga shoqëri e formës Shoqëri Anonime në Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar.

Nga : Administratoret,
Z.Musa Kalia
Znj.Resilda Kalia

Drejtuar: Aksionereve të shoqërisë "LIQENI VII" sh.a Durrës
1- Aksionerit Z.Ramazan Kalia,
2- Aksionerit Z.Kujtim Deti,
3- Aksionerit Znj.Shpresa Deti,
4- Aksionerit Znj.Arbertina Berzezi.

Në cilësinë e Administratoreve të shoqërisë "LIQENI VII" sh.a. konform dispozitave ligjore të nenit 216, 229 të ligjit 9901, dt.14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" të Statutit të shoqërisë, po ju drejtohem për t'ju komunikuar se mbledhja e asamblesë e cila do të zhvillohet me daten 14.11.2022 ora 11:00, për të shqyrtuar ndryshimin të formës ligjore, nëpërmjet shndërrimit nga shoqëri e formës shoqëri anonime në shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, për shkak të mospjesemarrjes së asnjërit prej aksionerëve të Shoqërisë do të zhvillohet serish pranë selisë së shoqërisë të shoqërisë "LIQENI VII" sh.a.(Rruga "Dituria", Zona Kadastrale nr.8516, Nr.pasurie 10/268, Lagjia 14, Kodi Postar 2007, Shkozet) në datën 10.12.2022, ora 10.00.

Rendi i ditës së kësaj mbledhje do të jetë si më poshtë:

- Shqyrtimi i ndryshimit të formës ligjore, nëpërmjet shndërrimit nga shoqëri e formës shoqëri anonime në shoqëri me përgjegjësi të kufizuar.
- Shqyrtimi dhe miratimi i raportit të administrimit ku do të shpjegohen në mënyrë të hollësishme, bazat ligjore dhe ekonomike të shndërrimit të propozuar. Në raport do të përshkruhen edhe vështirësitë e veçanta të vlerësimit, të cilat janë hasur. Në raport do të përshkruhet edhe efekti, që do të ketë shndërrimi tek punëmarrësit e shoqërisë.
- Shfuqizimin e Statutit të Shoqërisë si Statut i një Shoqëri Anonime "LIQENI VII" sh.a dhe miratimi i Statutit të ri të Shoqërisë si Statut i Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar "LIQENI VII" Sh.p.k.
- Të tjera.

Mbledhja do të organizohet pranë selisë së shoqërisë, Rruga "Dituria", Zona Kadastrale nr.8516, Nr.pasurie 10/268, Lagjia 14, Kodi Postar 2007, Shkozet), në datën 10.12.2022, ora 10:00.

ADMINISTRATORET

Z.Musa Kalia



Znj.Resilda Kalia





Address: Lagjia 14, Rruga "Dituria", Ish UMB, Shkozet, Durrës
Mobile: +355697037155
E-mail: info@LIQENI7.al
Website: www.LIQENI7.al

Durrës, me 10.12.2022

RAPORT I ADMINISTRATORIT PËR SHNDËRRIMIN E SHOQËRISË "LIQENI VII" NGA SHOQËRI AKSIONARE NË SHOQËRI ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

Në zbatim të nenit 228 pika 1 germa "a", të nenit 229 pikat 1,2,5,6,7 e 8 të Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtare e Shoqëritë Tregtare", të Statutit shoqëria "LIQENI VII" Sh.a. harton këtë Raport të hollesishëm të administrimit të shoqërisë për procedurën e riorganizimit duke ndryshuar formën e vet ligjore, nëpërmjet shndërrimit nga shoqëri e formës shoqëri aksionare në shoqëri me përgjegjësi të kufizuar si më poshtë:

1-BAZA LIGJORE

Shoqëria "LIQENI VII" sh.a., person juridik i së drejtës shqiptare, i regjistruar me Vendimin nr. 21244, datë 29.04.1999 të Gjykatës Tiranë, me seli: Rruga "Dituria", Zona Kadastrale nr.8516, Nr.pasurie 10/268, Lagjia 14, Kodi Postar 2007, Shkozet-Durrës, numer NIPT-i me kapital të regjistruar në vlerë 54.978.000 leke, dhe perfaqesohet nga administratori Z.Musa Kalia.

Riorganizimi i shoqërisë për ndryshimin të formës së vet ligjore nëpërmjet shndërrimit bëhet në bazën ligjore dhe ekonomike si më poshtë:

1. Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtare e Shoqëritë Tregtare" Neni 228 pika 1 germa "a" dhe neni 229.
2. Ligji Nr.9723, datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit".
3. Ligji nr. 25/2018 datë 10.05.2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".
4. Statuti i shoqërisë "LIQENI VII" sh.a.
5. Në Pasqyrat financiare të vitit 2021 ku janë përcaktuar dhe treguesit ekonomiko-financiare të shoqërisë.

2-MOTIVET DHE QËLLIMI I SHNDËRRIMIT

Arsyet që çojnë në një operacion të tillë riorganizimi, të shndërrimit të shoqërisë nga SHA në SH.P.K. sqarohen si mëposhte vijon:

Se pari "LIQENI VII" sh.a që nga koha e krijimit të shoqërisë dhe deri në momentin që shoqëria shndërrohet në formën SHPK, nuk ka pasur një zgjerim në tregje të reja, në investime në inovacion në fushën e shërbimit etj. Se dyti forma e administrimit si shoqëri aksionare nuk i ka krijuar mundësinë shoqërisë për të qënë më e dukshme përballë syve të investitorëve, si dhe kostoja e parasë në formën e SHA është vlerësuar me e lartë. Se treti, duke qenë se edhe objekti i veprimtarisë së shoqërisë e kërkon një mundësi të tillë, pas këtij shndërrimi shoqëria "LIQENI VII" sh.a. do të ketë mundësi me të shpejtë vendimarrje. Se katërti, sistemi ligjor, ekonomia dhe tregu i Shqipërisë, për shoqëritë e formës shoqëri aksionare nuk kanë krijuar lehtësira në krahasim me format e tjera të shoqërive. Se pesti, shoqëritë e formës aksionare kanë patur vështirësi dhe përballë presioneve të konkurrencës globale. Se gjashti dhe ndër arsyet me të rëndësishme, Shoqëria për disa vite ka rezultuar me rezultate pozitive por me riorganizimin e shoqërisë mendojmë të maksimizojmë këto rezultate.





Address: Lagjia 14, Rruga "Dituria", Ish UMB, Shkozë, Durrës
 Mobile: +355697037155
 E-mail: info@LIQENI7.al
 Website: www.LIQENI7.al

Për sa mesipër, theksojmë se shndërrimi i shoqërisë tregtare nuk sjell pasoja mbi të drejtat dhe detyrimet që shoqëria ka marrë përsipër ndaj të tretëve.

3-AKTIVET dhe PASIVET(DETYRIMET)

Operacioni i riorganizimit duke ndryshuar formën e vet ligjore nëpërmjet shndërrimit nga shoqëri e formës shoqëri aksionare në shoqëri me përgjegjësi të kufizuar parashikohet sipas elementeve të Aktivit dhe Pasivit të shoqërisë referuar në Pasqyrat Financiare të vitit 2021.

Grupet Kryesore të Aktiveve dhe Pasiveve të Shoqërisë "LIQENI VII" sh.a. në shoqëri "LIQENI VII" sh.p.k. janë caktuar, vlerësuar dhe pranuar sipas Pasqyrave Financiare të datës 31.12.2021. Këto pasqyra deklarohen pranë organeve tatimore dhe QKB si dhe sipas nenit 216 të Ligjit Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare, si dhe shoqëria ka hartuar dhe u ka vënë në dispozicion aksionerëve pasqyra kontabël për gjendjen e shoqërisë në datën 31.12.2021, si mëposhtë:

AKTIVE	
Aktivitet Afatshkurtera	254.961.386
Aktive Monetare	26.818.311
Të tjera financiare	10.900
Të drejta të arkëtueshme	180.850.560
Inventarët	46.753.023
Shpenzime të shtyra	399.020
Të arkëtueshme nga të ardhura të konstatuara	129.572
Aktivitet Afatgjata	584.458.592
Aktive Afatgjata Materiale(AAM)	73.476.126
Aktivitet Afatgjata Jomateriale(AAJM)	0
Aktivitet Biologjike	700.000
Totali I Aktiveve	329.137.512
PASIVE	
Detyrimet Afatshkurtera	223.071.409
Detyrime ndaj institucioneve të kredise	121.724.426
Arketime në avanse për porosi	3.416.543
Te pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit	65.675.930
Te pagueshme ndaj punonjësve dhe sigurimeve shoqërore	2.470.216
Te pagueshme për detyrimet tatimore	7.543.270
Tetjera të pagueshme	22.241.024
Te ardhura të shtyra	
Detyrime Afatgjata	5.385.302
Detyrime ndaj institucioneve të kredise	5.127.302
Detyrime tatimore të shtyra	





Address: Lagjia 14, Rruga "Dituria", Ish UMB, Shkozet, Durres
 Mobile: +355697037155
 E-mail: info@LIQENI7.al
 Website: www.LIQENI7.al

<i>Të tjera të pagueshme</i>	258.000
<i>Totali I Detyrimeve</i>	228.456.711
KAPITALI	100.680.801
Kapitali I nenshkruar	54.978.000
<i>Rezerva të Tjera dhe Ligjore</i>	1.652.776
<i>Fitime/Humbje te pashperndara</i>	19.622.191
<i>Fitime/Humbje te vitit</i>	24.427.834
<i>Totali I Pasiveve</i>	329.137.512

4-MODALITETET

Shoqëria "LIQENI VII" sh.a e cila do të shndërrohet në një formë të re si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar në datën e realizimit përfundimtar të riorganizimit (shndërrimit) gëzon frutet e shndërrimit duke filluar nga data e miratimit të riorganizimit të shndërrimit të shoqërisë nga asambleja e aksionereve të shoqërisë me kusht realizimin në fjalë.

Nuk do të ketë ndryshim në zotërimin e kapitalit të shoqërisë Shoqërisë "LIQENI VII" sh.a që do të shndërrohet në formën e re shoqëri me përgjegjësi të kufizuar "LIQENI VII"sh.p.k.

Në vazhdim shoqëria do të vazhdojë të njëjtin objekt veprimtarie, si dhe do të ketë të njëjtën seli. Për shkak të ndryshimit të formës ligjore, nëpërmjet shndërrimit nga shoqëri e formës shoqëri aksionare në shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, aksionerët shprehen për miratimin e shfuqizimit të dokumentave ligjore të krijimit të shoqërisë, pra Statuti, si dhe miratimin e dokumentacionit përkatës sipas ligjit për regjistrimin e shoqërisë me formën e re ligjore, pra të Statutit të ri të Shoqërisë si Statut I Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar "LIQENI VII" Sh.p.k.

Titulli i Statutit të Shoqërisë ndryshon dhe bëhet nga "Statut i Shoqërisë Aksionare "LIQENI VII"sh.a., në Statut i Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar "LIQENI VII" Sh.p.k.

Raporti i këmbimit është miratuar nga aksionerët duke mos patur ndryshime, pra do të jenë të njëjtat raporte këmbimi të aksioneve sipas përqindjeve në pjesëmarrjen në kapitalin e shoqërisë me të njëjtë % të zotërimit të kapitalit nga ortakët .

5-RAPORTET E KËMBIMIT

Kapitali i Shoqërisë "LIQENI VII" sh.a që do të shndërrohet në një formë të re, në një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar "LIQENI VII"sh.p.k. nuk do të ketë ndryshim në zotërimin e kapitalit të shoqërisë në përqindje, pra kapitali i shoqërisë do të zotërohet nga të njëjtët ortakë me të njëjtat përqindje. I vetmi ndryshim në këtë operacion riorganizimi është se zotëruesit e kapitalit do të quhen ortakë dhe jo aksionere, si dhe kapitali i shoqërisë nuk do të përbëhet nga aksione, por nga pjesë(kuota).

Raporti i këmbimit miratohet nga aksionerët duke mos patur ndryshime, pra do të jenë të njëjtat raporte këmbimi të aksioneve sipas përqindjeve në pjesëmarrjen në kapitalin e shoqërisë me të njëjtat % të zotërimit të kapitalit nga ortakët të ndarë në pjesë (kuota).





Address: Lagjia 14, Rruga "Dituria", Ish UMB, Shkozet, Durres
Mobile: +355697037155
E-mail: info@LIQENI7.al
Website: www.LIQENI7.al

Kapitali prej 54.978.000 lek i Shoqërisë "LIQENI VII" sh.a., mbas riorganizimit nepërmjet shndërrimit në shoqëri me përgjegjësi të kufizuar "LIQENI VII" sh.p.k. do të zotërohet nga ortakët:

- Z.Ramazan Kalia zoteron 99,76% te kapitalit, në vlerë prej 54.847.000 lekë i përbëre nga një pjesë me vlerë prej 54.847.000 lekë,
- Z.Kujtim Deti zotëron 0,09% te kapitalit, në vlerë prej 49.000 lekë i përbëre nga një pjesë me vlerë prej 49.000 lekë,
- Znj.Shpresa Deti zotëron 0,09% te kapitalit, në vlerë prej 49.000 lekë i përbëre nga një pjesë me vlerë prej 49.000 lekë,
- Znj.Arentina Berzezi zotëron 0,06% te kapitalit, në vlerë prej 33.000 lekë i përbëre nga një pjesë me vlerë prej 33.000 lekë.

6-TË DREJTA DHE AVANTAZHE TË TJERA

Ky operacion riorganizimi nepërmjet shndërrimit në një formë të re, në shoqëri me përgjegjësi të kufizuar "LIQENI VII" sh.p.k. nuk do të përmbaje të drejta dhe avantazhe të vecanta pas përfundimit të operacionit të riorganizimit(shndërrimit).

7-VËSHTIRËSITË E VECANTA TË SHNDËRRIMIT

Operacioni i riorganizimi nepërmjet shndërrimit në një formë të re, në shoqëri me përgjegjësi të kufizuar "LIQENI VII"sh.p.k. vlerësimi për aktivet dhe pasivet ashtu edhe përcaktimi i kapitalit nuk ka vështirësi të vecanta.

Nisur nga sa sqaruam mesiper si dhe per shkak se zotërimi i kapitalit është nga të njëjtët aksionerë/ortakë, është propozuar edhe përjashtimi i Eksperteve të fushave të ndryshme, si e drejte qe i lind referuar Ligjit nr. 9901, date 14.04.2008"Për Tregtare e Shoqërite Tregtarë".

8-EFEKTET E SHNDËRRIMIT MBI KREDITORËT, TË TRETËT DHE PUNONJËSIT E SHOQËRISË.

- Klientet, Debitorët, Kontratat, do të respektohen në të gjithë të drejtat dhe detyrimet në kontratat e lidhura midis shoqërisë "LIQENI VII" sh.a., duke u konsideruar që janë lidhur nga shoqëria e shndërruar në formën e re me përgjegjësi të kufizuar "LIQENI VII" sh.p.k.
- Të gjitha të drejtat dhe detyrimet e Debitoreve të shoqërisë së shndërruar Shoqëria "LIQENI VII" Sh.a. do ti respektoje Shoqëria e formës së re "LIQENI VII" sh.p.k., në vazhdimësi.
- Kreditorët, Furnitorët, Bankat, do të gëzojnë të gjithë të drejtat që kanë tek Shoqëria e shndërruar, pas këtij riorganizimi të gjithë të drejtat e kreditorëve (Ortakë, Furnitorët, Bankat) do të përmbushen nga shoqëria e formës së re "LIQENI VII" sh.p.k.
- Organet Tatimore, do të gëzojnë të gjitha të drejtat që kanë tek Shoqëria e shndërruar, pas këtij riorganizimi të gjitha të drejtat e tyre do të përmbushen nga Shoqëria e formës së re "LIQENI VII" sh.p.k.





Address: Lagjia 14, Rruga "Dituria", Ish UMB, Shkozet, Durres
Mobile: +355697037155
E-mail: info@LIQENI7.al
Website: www.LIQENI7.al

- Pas riorganizimit nepërmjet shndërrimit punonjësit aktuale do të gëzojnë të gjithë të drejtat që kanë tek Shoqëria e shndërruar, pra të gjitha të drejtat e punonjësve do të përmbushen nga Shoqëria e formës së re "LIQENI VII" sh.p.k.

9-TË DHËNAT E SHOQËRISË SË SHNDËRRUAR PAS RIORGANIZIMIT

Pas përfundimit të operacionit të riorganizimit nepërmjet shndërrimit në një formë të re, nga shoqëri aksionare në shoqëri me përgjegjësi të kufizuar "LIQENI VII" sh.p.k. do të jenë:

- Selia; Durrës, Rruga "Dituria", Zona Kadastrale nr.8516, Nr.pasurie 10/268, Lagjia 14, Kodi Postar 2007, Shkozet .
- Administratori i vetëm z. Musa Kalia me kompetencat:
 - Kompetenca të plota dhe me të gjitha të drejtat e perfaqësimit në çdo institucion shtetëror/privat dhe çdo institucion tjetër, person fizik/juridik apo individ me të cilët Shoqëria do të ketë marrëdhënie (përveç institucioneve financiare bankare ose jo, e cila vijon mëposhte).
 - Perfaqësimin në çdo institucion financiar (bankar ose jo) bashkërisht me aksionerin kryesor z. Ramazan Kalia. Z. Musa Kalia nuk ka të drejtë të kryejë asnjë veprim në asnjë institucion financiar (bankar ose jo) pa paraqitur gjithashtu edhe miratimin e z. Ramazan Kalia.
- Emërtimi shoqërisë do të jetë "LIQENI VII" sh.p.k.
- Kapitali i shoqërisë "LIQENI VII" sh.p.k. do të jetë në vlerë absolute prej **54.978.000 (pesëdhjetekatërmiljonenëntëqintëshekëdhjetetëmijëlekë)** dhe do të zotërohet nga ortakët:
 - Z.Ramazan Kalia zotëron 99,76% të kapitalit, në vlerë prej 54.847.000 lekë i përbërë nga një pjesë me vlerë prej 54.847.000 lekë,
 - Z.Kujtim Deti zotëron 0,09% të kapitalit, në vlerë prej 49.000 lekë i përbërë nga një pjesë me vlerë prej 49.000 lekë,
 - Znj.Shpresa Deti zotëron 0,09% të kapitalit, në vlerë prej 49.000 lekë i përbërë nga një pjesë me vlerë prej 49.000 lekë,
 - Znj.Arentina Berzezi zotëron 0,06% të kapitalit, në vlerë prej 33.000 lekë i përbërë nga një pjesë me vlerë prej 33.000 lekë.
- Objekti: Prodhim dhe tregtim pjesë këmbimi për makineri bujqësore, të ndërtimit, transportit etj. Tregtim me shumicë dhe pakicë të çdo lloji detali, nyje apo aksesori të makinerive bujqësore, të ndërtimit, transportit etj. Tregtim, import-eksport, furnizim dhe shpërndarje me shumicë e pakicë të materialeve dhe pajisjeve industriale, pajisjeve elektrike, mekanike, hidraulike, ndërtimi, izoluese, kimike, plastike, dekorit etj. Import-eksport të mallrave, materialeve makinerive dhe lëndëve të para që kanë lidhje me aktivitetin e saj prodhues dhe tregtar. Mbarështim pyjor, pyllëzime e përmirësime pyjore, mbarështim të faunës, mbrojtjen e pyjeve nga sëmundjet, demtuesit dhe nga zjarri, mbarështim kullotash e livadhesh, gjelbërim qytetesh e parkesh kombëtare. Projektim, ndërtim dhe rikonstruksion rrugësh pyjore. Punime të ndryshme ndërtimi, kanalizime, ura, vepra arti. Prodhim për përdorim dhe shitje të materialeve inerte, hapjen e linjave të inerteve, asfalto betoneve, materiale të ndërtimit.Gërmim, transport grumbullim dhe përpunim të mbetjeve urbane. Gërmim, transport grumbullim dhe përpunim dheu dhe mbetje të ndryshme ndërtimore dhe inerte. Rikonstruksione të çdo lloji. Tregtim me pakicë të karburanteve dhe vajra lubrifikante. Investime dhe shërbime në fushën e turizmit (Bar, Restorant, Hotel etj.). Agjenci





Address: Lagjia 14, Rruga "Dituria", Ish UMB, Shkozet, Durres
Mobile: +355697037155
E-mail: info@LIQENI7.al
Website: www.LIQENI7.al

turistike dhe udhëtimesh. Agjenci shitblerje biletash të transportit ajror, detar, hekurudhor urban e interurban. Dizenjim, programim, zhvillim, konsulence, shërbime dhe veprimtari në fushën e sistemeve të telekomunikacionit, informatikës dhe instalimit të rrjeteve kompjuterike. Aktivitet në shërbime të përpunimit të të dhënave. Aktivitet në shërbime të hostimit të bazave të të dhënave përkatëse. Aktiviteti i Manaxhimit të Projekteve me objekt ICT. Ndërmjetesi në lidhje me shitjen dhe qiradhënen me shumicë dhe pakicë të cdo lloj pasurie të ndryshme të patundshme të përcaktuar ligjshëm. Aktivitet në fushën e vlerësimit të pasurive të patundshme dhe hapja e degeve apo zyrave në rast nevojë për arritjen e qëllimit të shoqërisë dhe zhvillimin me tej të aktivitetit. Aktiviteti i shitjes së cdo lloj produkti apo shërbimi që ka në objektin e veprimtarisë. Magazinimi dhe/ose trajtim i mbetjeve të tjera të ujrave të zeza urbane duke përfshirë: Lumin nga ujrë e ndotura urbane, lumin e cisternave septike, mbetjet e ujrave të zeza nga gropat e hapura, mbetjet nga pastrimi i kanaleve të ujrave të zeza.

10- Ligji i zbatueshëm i Riorganizimit të Shoqërive është ligji Shqiptar. Cdo mosmarrëveshje apo konflikt në lidhje me operacionin e riorganizimit nëpërmjet shndërrimit do të zgjidhet përfundimisht nga Gjykatat Kompetente Shqiptare.

11- Riorganizimi i shoqërisë nëpërmjet shndërrimit hyn në fuqi ditën në të cilën miratohet nga asambleja e aksionerëve të shoqërisë sipas afateve të miratuara nga asambleja.

Për "LIQENI VII" sh.a.

ADMINISTRATORI

Z.Musa KALIA





Address: Lagjia 14, Rruga "Dituria", Ish UMB, Shkozë, Durrës
Mobile: +355697037155
E-mail: info@liqeni7.al
Website: www.liqeni7.al

PROCES VERBAL

I ASAMBLESË TË AKSIONERËVE TË SHOQËRISË "LIQENI VII" SH.A. PËR SHNDËRRIM

Sot me datë 10.12.2022 (dymijë e njetë e dy), u mbajt mbledhja e asamblesë së aksionerëve të shoqërisë: "LIQENI VII" person juridik i së drejtës shqiptare, i regjistruar me Vendimin nr. 21244, datë 29.04.1999 të Gjykatës Tiranë, me seli: Rruga "Dituria", Zona Kadastrale nr.8516, Nr. pasurie 10/268, Lagjia 14, Kodi Postar 2007, Shkozë-Durrës, numer NIPT-i K01730502W.

Mbledhja e Asamblesë të Aksionerëve të Shoqërisë mbahet me datën 10.12.2022, pranë zyrave të shoqërisë, sipas njoftimit të bërë nga Administratori që mban datën 22.10.2022, si dhe të rinjoftimit për shtyrjen të mbledhjes së asamblesë së aksionerëve të shoqërisë "LIQENI VII" sh.a. që mban datën 15.11.2022 i cili njofton perseristjen e mbledhjes në datën 10.12.2022 ora 10:00 për shkak të mospjesëmarrjes së asnjërit prej aksionerëve në mbledhjen e thirrur në datën 14.11.2022 ora 10:00 me rend dite si me poshtë:

- Shqyrtimi i ndryshimit të formës ligjore, nëpërmjet shndërrimit nga shoqëri e formës shoqëri anonime në shoqëri me përgjegjësi të kufizuar.
- Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit të administrimit ku do të shpjegohen në mënyrë të hollësishme, bazat ligjore dhe ekonomike të shndërrimit të propozuar. Në raport do të përshkruhen edhe vështirësitë e veçanta të vlerësimit, të cilat janë hasur. Në Raport do të përshkruhen edhe efekti, që do të ketë shndërrimi të punëmarrësit e shoqërisë.
- Shfuqizimin e Statutit të Shoqërisë si Statut i një shoqëri anonime dhe miratimi i Statutit të ri të Shoqërisë si Statut i Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar "LIQENI VII" Sh.p.k.
- Të tjera.

Në mbledhje morën pjesë aksionerët:

- Ramazan Kalia, i biri i Hamitit, shtetas Shqiptar, i lindur me 02 Prill 1963 në Dibër, Mbajtës i Letër njoftimit. 034067695, banues në Tiranë, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, zotëues i 99,96 % të aksioneve të shoqërisë "LIQENI VII" sh.a.

Në mbledhje merr pjesë edhe administratori i shoqërisë Z.Musa Kalia, pa të drejtë vote, dhe për të mbajtur këtë Proces Verbal të mbledhjes së Asamblesë të shoqërisë "LIQENI VII" aksioneri cakton Z. Musa Kalia.

Në Asamblenë e aksionerëve të Shoqërisë "LIQENI VII" sh.a. të mbledhur sot në datë 10.12.2022 mori pjesë vetëm njëri prej aksionerëve edhe pse kjo mbledhje ishte planifikuar për tu zhvilluar me datë 14.11.2022 për shkak të mospjesëmarrjes në mbledhje të aksionerëve u shty të bëhej me datë 10.12.2022 ku përsëri u konstatua mos prezenca e tre aksionerëve (Z.Kujtim Deti me 0,09 % të kapitalit/aksioneve, Znj.Shpresa Deti me 0,09 % të kapitalit/aksioneve, dhe Znj. Arbentina Berzezi me 0,06 % të kapitalit/aksioneve). Për mos pjesëmarrjen në mbledhje të tre aksionerëve të tjerë që zotërojnë në total prej 0,24% të kapitalit të shoqërisë u kërkua informacion si është bërë njoftimi i aksionerëve për zhvillimin e kësaj mbledhje. Administratori deklaroi se Njoftimi i aksionerëve është bërë me anë të shtypit dhe konkretisht në dy gazetën me tirazh kombëtar "Panorama" dhe "Dita", si dhe rinjoftimi në Gazetën "Panorama" dhe "Dita" në datën 15.11.2022.

Aksioneri i pranishëm Z.Ramazan Kalia shprehet se edhe pse aksionerët nuk janë të pranishëm ndonëse njoftimi i tyre është bërë në përputhje me kërkesat e ligjit dhe statutit të shoqërisë, të zbatohet pika 3 e nenit 229 të Ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".

Aksioneri i pranishëm Z.Ramazan Kalia zotëruar i 99,76% të aksioneve/kapitalit të shoqërisë mori në shqyrtim rendin e ditës si më poshtë:



Address: Lagjia 14, Rruga "Dituria", Ish UMB, Shkozet, Durrës
Mobile: +355697037155
E-mail: info@liqeni7.al
Website: www.liqeni7.al

- Shqyrtimi i ndryshimit të formës ligjore, nëpërmjet shndërrimit nga shoqëri e formës shoqëri anonime në shoqëri me përgjegjësi të kufizuar.
- Shqyrtimi dhe miratimi i raportit të administrimit ku do të shpjegohen në mënyrë të hollësishme, bazat ligjore dhe ekonomike të shndërrimit të propozuar. Në raport do të përshkruhen edhe vështirësitë e veçanta të vlerësimit, të cilat janë hasur. Në raport do të përshkruhet edhe efekti, që do të ketë shndërrimi tek punëmarrësit e shoqërisë.
- Shfuqizimin e Statutit të Shoqërisë si Statut i një Shoqëri Anonime "LIQENI VII" sh.a dhe miratimi i Statutit të ri të Shoqërisë si Statut i Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar "LIQENI VII" Sh.p.k.
- Të tjera.

Asambleja e Aksionerëve të Shoqërisë "LIQENI VII" Sh.a. pasi mori në shqyrtim rendin e ditës të caktuar nga Administratori i shoqërisë, për diskutimin e propozimit të Administratorit të Shoqërisë "LIQENI VII" sh.a. aksioneri u shpreh për miratimin e ndryshimit të formës ligjore, nëpërmjet shndërrimit nga shoqëri e formës shoqëri aksionare në shoqëri me përgjegjësi të kufizuar sipas raportit të administrimit ku janë shpjeguar në mënyrë të hollësishme, bazat ligjore dhe ekonomike të shndërrimit të propozuar. Në raport gjithashtu janë përshkruar edhe vështirësitë e veçanta të vlerësimit, të cilat janë hasur, si dhe efekti, që do të ketë shndërrimi tek punëmarrësit e shoqërisë. Aksioneri pas shqyrtimit të raportit të administrimit shprehet për miratimin e raportit të administrimit për shndërrimin nga shoqëri e formës shoqëri aksionare në shoqëri me përgjegjësi të kufizuar.

Gjatë diskutimeve u vu re se në Qendrën Kombëtare të Biznesit është pasqyruar një % prej 99,96% të zotërimit të aksioneve, në fakt kjo % duhet të jetë prej 99,76%, pra ky pasqyrim është një lapsus dhe % e zotërimit të aksioneve/kapitalit të aksionerit Z.Ramazan Kalia është prej 99,76% dhe jo 99,96%.

Kapitali themeltar i shoqërisë pas shndërrimit të shoqërisë "LIQENI VII", nga Shoqëri Aksionare (SH.A.), në Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar (SH.P.K.) nuk ndryshon pra mbetet në vlerë prej 54.978.000 lekë, i përbërë nga 54.978 aksione me vlerë prej 1.000 lekë secili aksion.

Për shkak të ndryshimit të formës ligjore, nëpërmjet shndërrimit nga shoqëri e formës shoqëri aksionare në shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, aksioneri shprehet për miratimin e shfuqizimit të dokumentave ligjore të krijimit të shoqërisë si Statutit si dhe miratimin e dokumentacionit përkatës sipas ligjit për regjistrimin e shoqërisë me formën e re ligjore, pra të Statutit të ri të Shoqërisë si Statut i Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar "LIQENI VII" Sh.p.k. Titulli i Statutit të Shoqërisë ndryshon dhe bëhet nga "Statut i Shoqërisë Aksionare "LIQENI VII" sh.a.", në "Statut të Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar "LIQENI VII" Sh.p.k."

Në pikën e rendit të ditës "Të tjera" nuk kishte diskutime shtese.

Në përfundim Aksioneri i Shoqërisë "LIQENI VII" sh.a. pasi mori në shqyrtim rendin e ditës, në mbështetje të Ligjit nr. 9901 dt 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" si dhe Statusit të Shoqërisë:

VENDOSI

- 1- Miratimin e ndryshimit të formës ligjore, nëpërmjet shndërrimit nga shoqëri e formës shoqëri anonime në shoqëri me përgjegjësi të kufizuar.
